



Pranimar / Dorezuar Priljepljen / Prodato Received / Delivery	05-05	2021	1	viti god year
Organ / Shërbimi Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKIMSHICK	2190/2021		
Nr Prot Pr Prot Prot No			Shtepia Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
				113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.153/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.153/2021 të datës 18.03.2021 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër protokollit 3392 të datës 17.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 05.05.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.153/2021 të datës 18.03.2021 të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi, Udhëheqës i Divizionit të Mbështetjes Teknike, Pronave, Sigurisë Rrugore dhe Peshoreve në Departamentin për Menaxhimin e Rrugëve, pranë Ministrisë së Infrastrukturës, me datë 18.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1232/2021 të regjistruar me numër A.nr.153/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 3392 të datës 17.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, lidhur me emërimin e ushtruesit të detyrës të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.03.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Ministria e Infrastrukturës.

Këshilli, me datë 26.03.2021 ka pranuar përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 1232/2021 të datës 18.03.2021 të parashtruar nga ankuesi ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër të protokollit 05/2093 e datës 12.03.2021e parashtruar nga ankuesi tek Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm ne Ministrin e Infrastrukturës; Vendimin me numër 01-3392 te datës 17.04.2020 për caktimin e ushtruesit te detyrës se Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve; Opinionin ligjor me numër 3316 i datës 05.11.2019 e dhëne nga Ministria e Administratës Publike; Kërkesën për përgjigje në ankesë numër të protokollit 1399/2021 të datës 15.03.2021 e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1415/2021 të datës 26.03.2021 të Ministrisë se Infrastrukturës; Ndryshimin dhe Plotësimin i Akt Emërimit me numër të protokollit 3366 të datës 13.04.2018 të ankuesit Si dhe Akt Emërimin e datës 24.10.2011.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e përsëritur, dhe ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Mbështetjes Teknike, Pronave, Sigurisë Rrugore dhe Peshoreve në Departamentin për Menaxhimin e Rrugëve pranë Ministrisë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ankuesi, me datë 18.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 3392 të datës 17.04.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë se Infrastrukturës, lidhur me emërimin e ushtruesit të detyrës të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, gjatë administrimit të provave ka gjetur se ankuesi, për të njëjtën çështje, me datë 23.06.2020 ka parashtruar ankesë numër protokollit 1208/2020 të regjistruar me numër A.170/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kolegji, përmes Sekretarisë se Këshillit, është njoftuar se ankuesi, përveç ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me objektin e njëjtë të ankesës, ka hapur edhe konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Andaj, pas konstatimit se ankuesi për të njëjtën çështje ka paraqitur ankesë me datë 23.06.2020, dhe me pas ka hapur konflikt administrativ në gjykatën kompetente, dhe meqenëse kjo procedurë ende është e pa përfunduar, Kolegji vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 101 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 ku përcaktohet se: *një procedurë*



administrative tjetër, nisur sipas një kërkesë tjetër të paraqitur nga e njëjta palë me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, është ende në proces shqyrtimi dhe e papërfunduar.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.153/2021**

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Arkivit të KPMSHCK.

